



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neneve 15, 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 e në mbështetje të nenit 6 të Udhëzimit administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimet e përkohshëm, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë ----- miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Për formimin e komisionit përzgjedhës

Neni 1

Formohet komisioni përzgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitat e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të Institucioneve Edukative-Arsimore dhe Aftësuese Parauniversitare që janë në varësi të Komunës për vitin shkollor 2022/2023, në këtë përbërje:

- 1.1 Agim RRAQI-----përfaqësues i DKA-së kryesues
- 1.2 Arta HOTI-----përfaqësuese e këshillit të prindërve
- 1.3 Anëtar i tretë vjen nga MASH-ti, sipas udhëzimit administrativ, Nr-151/2020.
- 1.4 Anëtar dy përfaqësues të këshillit drejtues të institucionit edukativo-arsimor, një prind dhe një mësimdhënës në cilësinë e vëzhguesve pa të drejt vote në se cilin institucion ku është duke u zhvilluar procedura e konkursit.

Neni 2

Detyrë e këtij komisionit përzgjedhës është që të bëjë intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve të cilit kanë konkurruar në konkursin për pozita të drejtorit apo zëvendës drejtorit dhe në bazë të pikëve të fituar, bën ranglistën e kandidatëve dhe kandidatin me të suksesshëm ja rekomandon Kryetarit të Komunës për emërim në pozitën e drejtorit apo zëvendës drejtorit të shkollës sipas konkurs.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI